

INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

Seria e kërkimeve politike
PUNIMI #6

TRENDET E VOTIMIT **2000 - 2004**

Prishtinë, maj 2006



TRENDET E VOTIMIT

2000 - 2004

Prishtinë, maj 2006



Ky projekt është përkrahur nga Rockefeller Brothers' Fund dhe USAID.

Përgatitur nga: Ilir Dugolli dhe Leon Malazogu. Në këtë projekt kanë ndihmuar po ashtu ndihmës hulumtuesit: Valmir Ismaili, Ilire Hyseni, Liridon Elshani dhe Yll Buleshkaj.

Copyright © 2006 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj. pa lejen me shkrim të botuesit.
Luteni të kontaktoni: info@kipred.net ose +381 38 555 887.

Botuar nga:



KIPRED (Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave)
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtina, Kosovo (UNMIK)
Phone and Fax: +381 38 555 887
www.kipred.net

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	1
1. HYRJE	3
2. TRENDET E PËRGJITHSHME	5
A) Trupi votues në rritje	5
B) Trendet e daljes në votim / Rënie e ngadalshme	5
C) Dallimet komunale	9
D) Trendet e pjesëmarrjes së shqiptarëve dhe serbëve	10
3. TRENDET E VEÇANTA	11
A) Mësimi i demokracisë	11
4. CILËSIA E PËRFAQËSIMIT	13
A) Suksesi i partive	14
B) Suksesi i subjekteve tjera politike shqiptare	15
C) Shpërndarja gjeografike e votave	16
D) Partitë lokale	18
5. A PO ZBEHET LEGJITIMITETI?	20
A) Legjitimiteti i partive politike dhe sjelljet zgjedhore	20
B) “Ne dimë më mirë se votuesit”	21
C) Ndëshkimi i bartësve të pushtetit	22
D) Pushteti lokal po humb, përderisa opozita lokale po fiton	24
E) Nuk është duke fituar e gjithë opozita	24
F) Atëherë, politika lokale çon peshë	25
G) Tani mos-votuesit janë “partia” më e madhe	27
H) Mungesa e alternativave	27
I) Votuesit nuk shkojnë vetëm pas udhëheqësve të mëdhenj, por edhe pas politikës së suksesshme lokale	28
6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	30
Rekomandimet:	32
Shtojca I: Rezultatet sipas komunave	35

PËRMBLEDHJE

Një nga tiparet kryesore të një demokracie është të ketë zgjedhje të lira dhe të drejta si dhe të sigurojë se besimi i votuesve është përfaqësuar denjësisht në institucionet e zgjedhura për ti qeverisur ata. Politikanët kosovarë dhe diplomatët ndërkombëtarë shpenzojnë një pjesë të madhe të kohës së tyre duke folur për demokraci, mirëpo, ky punim sugjeron që themelimi i një demokracie funksionale në Kosovë lë mjaft për të dëshiruar. Ky vlerësim kundërshton deklaratimet e shumë zyrtarëve të zgjedhur dhe të përfaqësuesve të administratës ndërkombëtare. Në theksojmë se problemi është urgjent dhe se nuk mund të zgjedhet pa përmirësimin e linjave të përgjithshme të përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Kjo kërkon që strukturat e UNMIK-ut dhe IPVQ-së të vërejnë të metat e sistemit politik në përgjithësi, dhe të sistemit zgjedhor në veçanti, dhe të vendosin këto lartë në prioritet të barabartë me stabilitetin dhe statusin.

Ky punim analizon katër zgjedhjet e kaluara në Kosovë nga viti 2000 deri në 2004 dhe vlerëson efektet e tyre në kulturën e tanishme politike. Ky punim pajtohet me shumicën e vlerësimeve se zgjedhjet ishin të lira dhe të drejta. Mirëpo, nuk pajtohet me vlerësimin se besimi i qytetarëve është përfaqësuar denjësisht në zgjedhjen e përfaqësuesve kombëtarë dhe komunalë. Përderisa përfaqësuesit janë zgjedhur në mënyrë proporcionale, llogaridhënia e tyre mbetet e cunguar.

Sistemi zgjedhor që Kosova ka pasur deri tani, lista të mbyllura, përfaqësim proporcional, i ka shërbyer qëllimit të vetë në mandatin e parë. Ka lejuar partitë politike të konsolidohen në periudhën e menjëhershme pas luftës, por ka qenë vendim i gabueshëm për mandatin e dytë sepse Kosovës i duhej të hynte në një fazë të re të zhvillimit demokratik.

Siç vërejtëm më 2004 gjatë lobimit për të ndryshuar sistemin zgjedhor si pjesë e një lëvizjeje të shoqërisë civile, “Reforma 2004”, shumica e OJQ-ve, zyrtarëve të lartë të të gjitha partive (dy kryeministra dhe ish-kryetari i Kuvendit), si dhe shumica e zyrtarëve ndërkombëtarë në cilësi private kundërshtojnë sistemin e tanishëm. Ky lloj sistemi u ndihmon liderëve të partive të vejnë partitë nën kontroll të rreptë. Kjo ndodh sidomos në shoqëritë që nuk kanë demokraci të konsoliduar dhe si të tilla paraqesin një pengesë për konsolidim. Fatkeqësisht, politikanët që shprehin mendime të pavarura akoma konsiderohen të dëmshëm jo vetëm për liderët partiakë, por edhe për ata zyrtarë ndërkombëtarë të cilët mendojnë se statusi dhe siguria mund të zgjidhen pa demokraci. Si rezultat, ky sistem ka dekurajuar zhvillimin e një demokracie të mirëfilltë në llogari të disa interesave afatshkurta dhe të ngushtë.

Ky punim tregon se sistemi zgjedhor i tanishëm ka treguar efekte negative. Si rezultat, ne argumentojmë se nëse dëshirojmë demokraci, është thelbësore të ndryshojmë sistemin zgjedhor. Shoqëria kosovare ka nevojë për liderë të përgjegjshëm në të gjithë nivelet, parti të qeverisura në mënyrë demokratike, përfaqësim të denjë të interesave të ndryshëm, deputetë të cilët sjellin legjitimitet në institucione si dhe qeveri të qën-

drueshme. Dialogu i mirëfilltë në institucione zëvendëson “dialogun” destruktiv në rrugë.

Siç është komentuar nga disa vëzhgues ndërkombëtarë, disa zyrtarë ndërkombëtarë larg medimeve cilësojnë kosovarët si të papjekur. Mirëpo, marrja e vendimeve dhe mbledhja e nënshkrimeve gjatë darkave siç edhe ndodhi për vendimin për të biseduar me Beogradin nuk kompenson papjekurinë. Fakti se dialogu me Beogradin nuk filloi pas “darkës” është një indikator në këtë drejtim.

Qëllimi i punimit është të analizojë disa trende zgjedhore si, dalja në votim, efektiviteti i partive, trendet komunale, apo përkatësia etnike. Shpresa e administratës ndërkombëtare se demokracia mund të themelohet me dekret administrativ është e gabueshme. Përkundrazi, siç tregojnë rezultatet e prezantuara, qytetarët të cilët gjatë e kanë pritur demokracinë, e shohin situatën e tanishme të pakënaqshme, të ngjyrosur si të suksesshme, kanë filluar të tregojnë shenja të lodhjes dhe të frustrimit me “demokracinë”. Krijimi i një distance të tillë në mes të qytetarëve dhe të përfaqësuesve të tyre si dhe me qeverinë edhe më tepër keqëson pikëpamjet e shumta për korrupsion dhe patronazh.

Argumenti thelbësor është se për shkak të udhëheqësisë të sistemit zgjedhor dhe për shkak të strategjive të bashkësisë ndërkombëtare, si dhe partiake, elita politike është duke e humbur një pjesë të madhe të përkrahjes së vet politike. Kjo është manifestuar në shumë mënyra, si rënia e shpejtë e daljes në votime, humbja e votës nga partitë në pushtet komunal, rënia e ndjeshme e hises së elektoratit të tri partive kryesore, të gjitha tipare që dëshmojnë një vakuum të rrezikshëm të legjitimitetit në shoqëri, që mund të shfrytëzohet në kohë të krizave që presin Kosovën në të ardhmen. Përderisa partitë politike mund të mos shohin interes të menjëhershëm që të ndryshojnë këtë sistem, sepse paraqet sfidë serioze për menaxhimin e tyre të brendshëm, ky punim vie në përfundim që ky sistem do t’ju ndihmonte partive më dinamike që të arrijnë tek votues të rinj. Një kulturë e tillë politike do t’ju ndihmonte partive më aktive të shpërblehen me vota shtesë për aktivitetin e tyre me publikun.

Përfundimisht, punimi rekomandon se sistemi zgjedhor të ndryshohet dhe diskutimet për ndryshime duhet të udhëhiqen nga parimet e llogaridhënies, paanësisë, përfshirja e pakicave, integrimi politik, përfaqësimi, pjesëmarrja e votuesve, qeverisja efektive, dhe mbi të gjitha, legjitimiteti. Ndryshimi i sistemit zgjedhor, në nivel lokal dhe kombëtar, nuk do të zgjidhte të gjitha problemet e theksuara më lartë, por gjithsesi do të ishte hap i ndjeshëm drejt ruajtjes së konceptit të demokracisë për kosovarët. Edhe pse ne nuk kemi iluzione se sistemi zgjedhor do të zgjidhte shumicën e mangësive të sistemit politik, disa nga ndryshimet gjithsesi do të ishin në favor të qytetarëve.

Ne rekomandojmë që zgjedhjet komunale të zhvillohen në sistem me lista të hapura, rezultate proporcionale, përfaqësim adekuat gjinor dhe etnik, pa ndarje të zonave, dhe me zgjedhje të drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave.

1. HYRJE

Me dekada, kosovarët kanë kërkuar mundësinë e të ushtruarit të të drejtave të tyre politike. Lufta kundër regjimit diskriminues gjatë nëntëdhjetave ishte përplot mund dhe retorikë që proklamonte të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur. Kjo fushatë e gjatë dhe e shumanshme kishte për qëllim, në mes tjerash, themelimin e institucioneve përfaqësuese dhe llogaridhënese. Në ndjekje të këtyre qëllimeve, përpjekjet e viteve të nëntëdhjeta gjithashtu përfshinë edhe votimet në sistemin paralel, edhe pse me efekt pothuajse simbolik për shkak të regjimit apartheid.

Vite më vonë, e drejta e votës në Kosovë mund të ushtrohet lirshëm, por megjithëkëtë, institucionet e vërteta përfaqësuese dhe llogaridhënese akoma mungojnë. Akoma ekzistojnë disa mangësi strukturore dhe të tjera të cilat e shkatërrojnë besimin e votuesit, linjat llogaridhënese dhe besimin në institucionet publike. Rrjedhimisht, ky punim shpjegon që zbrazësia e legjitimitetit është duke u zgjeruar.

Sistemi aktual zgjedhor shpallet nga zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) pasi është kthyer nga Zyra Ligjore në Nju Jork. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është “përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në Kosovë”. KQZ, i emëruar nga PSSP, merret me punë “teknike dhe profesionale” (OMiK). Sistemi zgjedhor aktual e trajton Kosovën si një njësi zgjedhore me shpërndarje proporcionale të vendeve të përfaqësuesve. Formula Sainte-Lague përdoret për të llogaritur shndërrimin e votave në mandate. Kuvendi ka 120 vende, prej të cilave 20 janë të rezervuara për bashkësitë jo-shqiptare. “Këto përfshijnë dhjetë vende për bashkësinë serbe, katër për romët, ashkallitë dhe egjiptasit, tre për bashkësinë boshnjake, dy për bashkësinë turke, dhe një për bashkësinë gorane. Këto vende u shtohen vendeve tjera të cilat bashkësitë mund t’i kenë fituar nga 100 vendet në Kuvend, e për të cilat votojnë të gjithë votuesit (OMiK “Summary...” 4). Listat e kandidatëve janë të mbyllura, duke nënkuptuar se votuesit votojnë për partinë politike dhe jo për kandidatin e caktuar. Gjithashtu, sistemi parashihet një kusht gjinor me ç’rast listat e kandidatëve duhet të kenë së paku 1/3 femra. Nuk parashihet kurrfarë pragu minimal për përfaqësim në Kuvend për cilatdo subjekte politike (Marrur nga “Reformimi i sistemit zgjedhor në Kosovë” publikuar nga KIPRED, 2004).

E drejta për të votuar në Kosovë mund të ushtrohet lirshëm, por institucionet vërtetë përfaqësuese dhe llogaridhënese ende mungojnë

Ekzistojnë mangësi serioze në raportin në mes të votuesve dhe përfaqësuesve të tyre. Qytetarët nuk mund të dinë se cili përfaqësues i zgjedhur flet në emrin e tyre; prandaj nuk ka raport në mes të zyrtarëve të zgjedhur dhe votuesve. Si rezultat, linjat vertikale të llogaridhënies mungojnë tërësisht. Hallka kryesore lidhëse – partitë politike – të cilët duket se e keqkuptojnë disponimin e votuesve nuk

janë duke i vënë veshin sa duhet kërkesave dhe shpresave të qytetarëve. Rrjedhimisht, dalja e përgjithshme në votime është në ulje, ashtu siç është edhe akumulimi i përgjithshëm i votave nga partitë kryesore, që tregon pakënaqësi serioze.

Ndjenja e pafuqisë është në rritje e sipër tek votuesit që shkon në dëm të pjesëmarrjes cilësore. Ata nuk mund të kërkojnë llogari nga përfaqësues individualë për veprimet e tyre dhe nuk munden saktësisht të dinë se tek kush qëndron përgjegjësia për qeverisje. Deri sa pjesë të ndjeshme të trupit votues ndjehen të përjashtuar, themelet e legjitimitetit, mbi të cilat qëndrojnë institucionet dhe partitë politike, vazhdojnë të keqësohen. Një pjesë e vogël e votuesve në nivelin lokal ka reaguar duke dënuar partitë në pushtet në nivel komunal. Shumë të tjerë, sidoqoftë, ndjehen gjithnjë e më shumë të përjashtuar nga procesi vendimmarrës dhe po nixten të përdorin mjete “alternative” në mënyrë që zëri i tyre të dëgjohet – ata janë duke u tërhequr nga forma kryesore e pjesëmarrjes politike, dhe shpesh e vetmja, hedhja e votës.

Duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë, ky punim ka për qëllim të analizojë të drejtën e fituar rishtazi për kosovarët, votën, dhe të paraqesë trendet e votimit nga zgjedhjet e para të lira më 2000 deri në zgjedhjet e fundit të mbajtura më 2004. Kuptohet, një histori e shkurtër e zgjedhjeve është hendiKep serioz për identifikimin e trendeve votuese siç duhet. Mirëpo, disa trende modeste dhe mësimet të paraqitura këtu vlejnjë të analizohen, sidomos rënia e pjesëmarrjes qytetare dhe zgjerimi i vakuumit të legjitimitetit. Në mënyrë ideale, një studim i tillë duhet të shoqërohet me anketë publike që do të analizonte pyetje të tilla nga pikëpamja e grupacioneve të ndryshme të qytetarëve. Një kufizim tjetër është se kjo seri e katër zgjedhjeve fsheh dy palë zgjedhje lokale dhe dy kombëtare. Përkundër veçantive të këtyre zgjedhjeve, ne kemi analizuar rezultatet e krahasueshme që tregojnjë trende të vazhdueshme.

2. TRENDET E PËRGJITHSHME

A) Trupi votues në rritje

Një nga trendet më dramatike nga zgjedhjet e vitit 2000 deri më 2004 është rritja e elektoratit. Në zgjedhjet e vitit 2000 ishin 913.179 votues të regjistruar. Numri i votuesve potencial ishte shumë më i lartë, por një numër shumë i lartë i votuesve nga diaspora dhe bashkësitë etnike nuk ishin regjistruar, mangësi e cila u korrigjua në vitet në vazhdim. Rrjedhimisht, brenda vetëm katër viteve numri i votuesve të regjistruar është rritur për gjysmë. Një rritje e tillë natyrisht se nuk mund ti atribuohet vetëm rritjes natyrore. Prandaj, rritja e përgjithshme e elektoratit nga zgjedhjet e para deri më 2004 ishte e dukshme si në aspekt relativ ashtu edhe në atë absolut.

Tabela 1: Rritja e trupit elektorat

2000-2001	36,9%
2001-2002	5,6%
2002-2004	3,4%




Figura 1: Madhësia e elektoratit

filloi të shpejtohet shkalla e regjistrimit dhe shumica e serbëve u regjistruan para zgjedhjeve të treta të vitit 2002.

Diaspora gjithashtu arriti të regjistrohet në të njëjtin afat kohor sikur se edhe serbët, nga viti 2000 dhe 2002. Edhe pse ata mund të zgjedhnin të votojnë në Kosovë apo me postë, vetëm një pjesë e vogël e diasporës votoi.

Rritja më e shpejtë e numrit të votuesve të regjistruar ndodhi në mes të zgjedhjeve 2000, 2001 dhe 2002. Kjo rritje është e veçantë për shkak të regjistrimit të serbëve dhe të diasporës të cilët u regjistruan brenda dy deri tre vjetëve pas luftës.

Serbët ishin shumë të disiplinuar në bojkotimin e zgjedhjeve të para lokale. Vetëm pas zgjedhjeve të para

B) Trendet e daljes në votim / Rënie e ngadalshme

Një nga brengat qendrore që ky punim vë në pah është rënia e pjesëmarrjes së qytetarëve në votim. Zgjedhjet e para u shënuan me një entuziazëm të theksuar dhe me një dalje në votim prej 79%. Përkundër radhëve tejet të gjata që ishin pamje e shpeshtë në

Pjesëmarrja në votim zbriti nga 79% në 2000 në 49,5% në 2004

vendvotimet në të gjithë Kosovën, një pjesëmarrje aq e lartë pjesërisht ndodhi për shkak të euforisë së pas luftës dhe të entuziazmit me zgjedhjet e para aq të pritura në Kosovën e lirë. Për më tepër, pjesëmarrja në zgjedhje konsiderohej si

obligim qytetar-patriotik. Sidoqoftë, një nivel i tillë i daljes në zgjedhje duket pikë tejet e lartë referimi për të krahasuar me zgjedhjet e mëvonshme.

Përderisa nuk ka nevojë të vlerësohet pjesëmarrja duke i krahasuar me zgjedhjet e para,

Tabela 2: Pjesëmarrja në votim

Viti	Numri	Përqindja
2000	721.260	79%
2001	803.796	64,3%
2002	711.005	53,8%
2004	699.519	49,5%

kjo nuk do të thotë që nuk ka arsye për shqetësim për rënien e vazhdueshme në zgjedhjet vijuese. Ndonëse është e natyrshme të ketë një lloj rënie, kjo rënie e theksuar është brengosëse.

Pjesëmarrja e vitit 2000 pjesërisht ishte rritur nga fakti që serbët nuk ishin regjistruar. Çdo vlerësim për pjesëmarrje në votim, i lartë apo i ulët, duhet të merr parasysh bojkotimin e mundshëm nga ndonjë bashkësi. Mospjesëmarrja e tyre në zgjedhjet e mëvonshme (edhe pse të regjistruar) shpjegon një pjesë të rënies. Disa zyrtarë ndërkombëtar kanë argumentuar në këtë mënyrë për të minimizuar implikimet e daljes më të ulët në votim. Sidoqoftë, vetëm një pjesë e vogël e rënies prej 30% mund të shpjegohet me mospjesëmarrjen e serbëve. Ngjashëm, pjesëmarrja e ulët e diasporës ka një ndikim të vogël në këtë trend. Ky trend nuk mund t'i atribuohet as krizës së përfolur globale të demokracisë; Kosova akoma nuk ka filluar të funksionojë si demokraci.

Edhe pse rënia e pjesëmarrjes nga 2003 në 2004 është shumë e ulët në asnjë mënyrë nuk është arsye e mjaftueshme për kënaqësi. Së pari, nuk ka indikacione se rënia është ndalur, e lëre më të shpresohet në ngritje. Së dyti,

zgjedhjet qendrore natyrshëm konsiderohen si zgjedhje të “rangut të parë” dhe si të tilla ato tërheqin numër më të madh të votuesve në krahasim me zgjedhjet lokale. Prandaj, mund të thuhet se nëse zgjedhjet e 2004 nuk do të ishin të nivelit kombëtar, ne do të kishim qenë dëshmitar të një rënie edhe më të thellë në pjesëmarrje sesa që kishim. Po

Po ashtu mund të thuhet që nëse rrethanat që sollën në këtë rënie mbesin të njëjta edhe në vitin tjetër, pjesëmarrja në zgjedhjet lokale të vitit 2006 do jetë më e ulëta e të gjithave zgjedhjeve

ashtu mund të thuhet që nëse rrethanat që sollën në këtë rënie mbesin të njëjta edhe në vitin tjetër, pjesëmarrja në zgjedhjet lokale të vitit 2006 do jetë më e ulëta e të gjitha zgjedhjeve.




Figura 2: Partitë e mëdha të tejkaluara nga mosvotuesit

Shkalla e mosvotimit bëhet edhe më e dukshme kur i kushtohet vëmendje numrave absolut. Në 2004 rreth 602.690 votues nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje, që është numër

më i madh sesa numri i votave të mbledhura së bashku nga tri partitë kryesore (570.480 vota).

Fakti që shumë njerëz kanë vendosur për të mos e hedhur votën e tyre përkundër

Viti		LDK	PDK	AAK	Tjerët	Mosvotuesit
2000	Numri i votuesve	398.872	187.821	53.074	47.585	191.919
	Si % e votave të përgjithshme të vlefshme	50%	27,3%	7,7%	6,9%	21%
2001	Numri i votuesve	359.051	202.622	61.600	164.142	446.191
	Si % e votave të përgjithshme të vlefshme	43,7%	25%	7,6%	12,8%	35,1%
2002	Numri i votuesve	320.918	207.012	61.824	109.845	809.478
	Si % e votave të përgjithshme të vlefshme	45,9%	29,6%	8,8%	15,7%	46,2%
2004	Numri i votuesve	313.437	199.112	57.931	119.196	602.690
	Si % e votave të përgjithshme të vlefshme	45,1%	29,8%	8,4%	17,1%	48,4%

Tabela 3: Trendet e partive të mëdha dhe mosvotuesve

organizimit më të mirë dhe radhëve më të shkurtra mund t'i atribuohet: besimit të ulët në institucione, kalimit të kufizuar të kompetencave dhe llogaridhënies së tërthortë (sidomos pas zgjedhjeve të para lokale të cilat ishin mbajtur me lista të hapura, të gjitha zgjedhjet vijuese më lista të mbyllura). Rritja e distancës në mes të qytetarëve dhe institucioneve për shkak të efikasitetit të dobët kërkon vëmendje dhe duhet të rregullohet sa më herët.

Është e natyrshme se me lista të mbyllura partiake, partitë politike janë instrumenti thelbësor për përfaqësim. Niveli qendror i partive vendos për emrat që duhet të vendosen në listë, si dhe cilët emra vendosen lartë e cilët nuk do të kenë fare gjasë. Partitë po ashtu janë mjeti kryesor për vendosjen dhe përmirësimin e disiplinës dhe përgjegjësisë për përfaqësuesit e tyre të zgjedhur. Ky nuk do të ishte problem i madh sikur trekëndëshi ndërmjet qytetarëve, partive dhe përfaqësuesve të zgjedhur do të funksiononte mirë. Për më tepër, një marrëdhënie e tillë është duke forcuar marrëdhëniet parti-përfaqësues në dëm të marrëdhënieve votues - përfaqësues të partive politike.

Nëse partitë e mëdha nuk janë në gjendje të mobilizojnë shumicën e votuesve dhe në të njëjtën kohë partitë e vogla dhe iniciativat qytetare nuk mundën të fitojnë besim të mjaftueshëm për të garuar me partitë kryesore, atëherë legjitimiteti i tërë elitës politike ka arritur në një pikë kritike. Kjo rënie e legjitimitetit po bëhet gjithnjë e më e dukshme. Mospërputhja e kërkesave të qytetarëve dhe ofertave të partive politike po shpie në ulje të pjesëmarrjes. Qëndrimi në shtëpi në vend të votimit po bëhet më e arsyeshme për shumë kosovarë.

Një trend tjetër shqetësues është gjetja e raportit të fundit të zhvillimit njerëzor (2004), se kosovarët katër herë më tepër përfshihen në pjesëmarrje negative (psh. protestat publike) sesa në pjesëmarrje konstruktive (p.sh. anëtarësia në ndonjë sindikatë, OJQ, etj).

Një problem më rënien e shpejtë të daljes në votim është mënyra se si kjo të ndikonë

në partitë. Vlerësuar nga qëndrimet e partive politike, asnjëra nga to nuk ndjen që baza e tyre është shkatërruar më tepër se ajo e partive tjera. Në përgjithësi partitë politike nuk duken të gatshme të përpiqen që të zgjerojnë bazën e tyre elektorale duke kërkuar votues të rinj. Kryesisht, partitë duken të vetëkënaqura me shkatërrimin gradual të pozitave të tyre, vetëm sepse trendi i njëjtë i prek edhe partitë tjera, megjithëse në shkallë të ndryshme. Po ashtu nuk ka dëshmi të mjaftueshme që një parti beson që do të fitonte shumë nga rritja e mundshme e pjesëmarrjes apo që pjesëmarrja e ulët e ka goditur atë më tepër sesa partitë tjera konkurrense. Qëndrimi që çdo parti ka një humbje të barabartë të daljes së votave ka implikime brengosëse. Kjo do të thotë që ndjenja e sigurisë ndaj humbjes së votave në krahasim me partitë tjera nuk jep një ndonjë nxitje të fortë për t'u angazhuar në mënyrë më agresive në mobilizimin e votuesve përtej linjave të tyre tradicionale. Fakti që partitë fokusohen në mbajtjen e elektoratit të tyre bazë mund të jetë po ashtu një arsye pse një pjesë e qytetarëve ndjehen tejet të afër me partinë e tyre. Mosvotuesit, në anën tjetër mbesin jashtë sferës së interesit me partitë e fokusuar vetëm në elektoratin e tyre bazë. Në vend të përkrahjes së një sistemi elektorale që do të krijonte një numër të konsiderueshëm të votuesve që do të votonin për përzgjedhjen më të mirë në secilat zgjedhje, që do shtynte partitë të moderonin qëndrimet e tyre, kosovarët gjithnjë e më shumë janë duke rënë në dy kategori kundërshtuese, militantët dhe votuesit apatik. Partitë shikojnë shumicën e votuesve si të përcaktuar për kohë të gjatë dhe ndjehen të vetëkënaqur që as një subjekt i ri nuk do të mund ta rrëmbejë numrin në rritje të mosvotuesve. Kur partia që për nga madhësia tani është e katërta, ORA, vendosi të futet në betejë politike në 2004, ajo shqetësoi shumë politikanë të vjetër, edhe pse pak prej tyre e përmendën ORA-n si një kërcënim serioz.

Ky relaksim duket edhe më problematik kur vërehet që këto trende nuk ndryshojnë. Është e rrezikshme të mbështetemi në pjesëmarrje më të mirë dhe eliminim të zbrazëtirës së legjitimitetit duke ia lënë gjërat rrjedhës së tyre natyrale dhe duke shpresuar në ndryshimin e gjeneratave. Duke mos ditur tërësisht se çfarë zonash potenciale mund të tërheqin, partitë shpesh mbështeten në votuesit e rinj për të kompensuar humbjet e tyre, diç që vërehet nga përdorimi i tepruar i retorikës mbi rininë. Në anën tjetër, ata bëjnë përpjekje të vogla për të arritur tek votues tjerë përtej ithtarëve tradicional të tyre. Ky është një vetëmashtrim pasi që rinia, në krahasim me sektorët tjerë të shoqërisë, zakonisht është më e padisiplinuar në votim. Për më tepër, asnjë studim apo vëzhgim deri më tani nuk ka argumentuar për ndonjë trend të veçantë për votimin nga të rinjtë,

Nëse partitë e mëdha nuk janë në gjendje të mobilizojnë shumicën e votuesve dhe në të njëjtën kohë partitë e vogla dhe iniciativat nuk mund të marrin besimin e mjaftueshëm për të garuar me partitë kryesore, atëherë legjitimiteti i krejt elitës politike është në një gjendje kritike

dhe ka të ngjarë që këta të rinj të paktë që votojnë do të shpërndajnë votat e tyre tek partitë ekzistuese, pak a shumë në mënyrë proporcionale si i gjithë elektorati.

Trendet negative të gjertanishme nuk mund t'u atribuohen dallimeve në mes gjeneratave, kështu që ndryshimet e këtyre trendeve negative nuk mund të lihen e të presin gjeneratat e reja të votuesve të cilat në dekadat që vijnë mund të mbivotojnë të tjerët. Në të tri zgjedhjet pas atyre të vitit 2000 shumica e votuesve të rinj ishin ata të cilët nuk ishin përfshirë në listat e votuesve më herët e jo ata të cilët në ndërkohë kishin arritur moshën për të votuar. Prandaj, rritja e gjertanishme e elektoratit nuk mund t'i atribuohet zëvendësimit të gjeneratave apo dallimeve në moshë. Trupi elektoral nuk do të rritet me ritmin e deritanishëm dhe do të ketë ndikim të vogël në shpërndarjen e votave drejt partive.

Si përfundim, gjatë këtyre katër palë zgjedhjeve, pjesëmarrja në votim ka rënë në mënyrë ekstreme. Kjo rënie nuk mund të shpjegohet as me pragun e lartë fillestar, dallimet në gjenerata apo faktorë të tillë të ngjashëm. Rritja e mungesës së interesit në kombinim me dëshpërimin me të gjitha partitë, si dhe cilësia e përfaqësimit janë duke e lënë mosvotimin dhe format tjera negative të pjesëmarrjes si alternativa të vetme për ndryshime shoqërore.

C) Dallimet komunale

Trendet shpiejnë në një humbje serioze të besimit në partitë politike, gjë që duhet të ndalohet urgjentisht

Në nivelin lokal ka trende interesante. Disa komuna dallojnë sa i përket trendeve të pjesëmarrjes duke ruajtur një disiplinë të lartë të votuesve. Në vitin 2000, komunat me pjesëmarrjen më të lartë ishin: Rahoveci 90%, Novobërda 90%, dhe Shtërpca me 87%. Siç dihet edhe Novobërda edhe Shtërpca janë komuna me popullatë etnikisht të përzierë, mirëpo pasi që serbët bojkotuan zgjedhjet e vitit 2000 këto përqindje përfshijnë kryesisht votuesit shqiptar. Komunat me pjesëmarrjen më të ulët në vitin 2000 ishin Vitia me 69% të votuesve, Kamenica dhe Kaçaniku, të dyja me nga 75%.

Në vitin 2001, pjesëmarrja më e lartë ishte në Novobërdë (75,5%; po ashtu më e larta edhe në vitin 2002 me 81%), Shtërpçë (75,2%, në 2002 me 69%), që ishin të dyja në mes të tri komunave më pjesëmarrje më të lartë në vitin 2000 dhe Drenasi me 73,1%. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja më e ulët është regjistruar në komunat ku shumica e votuesve janë serbë: Zveçan

Pjesëmarrja në zgjedhjet lokale	2000	2002
Më e larta	90%	81%
Mesatarja	80%	55%
Më e ulëta	69%	30%

Tabela 4: Pjesëmarrja në zgjedhjet lokale

(18,6%), Zubin Potok (29,8%) dhe Leposaviq (45,2%). Në vitin 2004 komunat me pjesëmarrje më të lartë ishin tri komunat me shumicë shqiptare: Drenasi (65,8%), Shtimja (65,8%) dhe Deçani (59,8%), përderisa pjesëmarrja më e ulët ishte në komunat me shumicë serbe, Zubin Potoku (8,2%), Zveçani (1,9%) dhe Leposaviqi (0,8%).

D) Trendet e pjesëmarrjes së shqiptarëve dhe serbëve

Në përgjithësi serbët ngurronin për të marrë pjesë në zgjedhje nga frika e (a) legjitimitetit të proceseve të përgjithshme në Kosovë dhe (b) sundimit të shumicës shqiptare në nivel komunal. Veçanërisht është shqetësues fakti se pjesëmarrja e tyre ka rënë me kalimin e kohës nga 67% në 52% në zgjedhjet lokale, dhe nga 47% në 9% në zgjedhjet qendrore. Përderisa këto statistika masin pjesëmarrjen në nivel komunal dhe jo vetëm të serbëve, ato janë disi të pasakta sepse ndikohen nga regjistrimi i lartë shtuar nga viti në vit. Nga këto shifra dhe nga vrotimet e përgjithshme është e qartë se serbët kanë bojkotuar më shumë zgjedhjet qendrore sesa ato lokale. Madje një pjesëmarrje prej 52% që kishim në zgjedhjet lokale të 2002, ua mundësoi serbëve që të marrin shumicën në zgjedhjet lokale në komunat ku ata janë shumicë.

Përkundër qasjes së vakët të serbëve kundrejt zgjedhjeve, bazuar në deklaratat e kaluara të disa liderëve serbë, duket se bashkësia serbe ka vërejtur pasojat e bojkotit. Kjo tregon një konstatim të hidhur të mungesës së alternativave tjera legjitime për të arritur qëllimet e tyre. Gjithashtu, tregon një ndryshim të mundshëm afatgjatë brenda kësaj bashkësie pak të integruar ndaj institucioneve dhe një braktisje e mundshme e strategjisë refuzuese për integrim.

3. TRENDET E VOTIMIT

A) Mësimi i demokracisë

Fakti që katër palë zgjedhje janë mbajtur nga 2000 deri në 2004 ka pasur një ndikim të rëndësishëm tek votuesit, partitë, organizatorët e zgjedhjeve, me rezultate pozitive që mund të vërehen gjithnjë e më shumë. Menjëherë pas zgjedhjeve të para, numri i votave të pavlefshme është sjellë nën 2% dhe është mbajtur gjithnjë në këtë nivel të tolerueshëm. Në historinë e katër vjeçare të zgjedhjeve, edhe organizatorët e zgjedhjeve (OSBE dhe KQZ) por edhe votuesit kanë përparuar ndjeshëm.




Figura 3: Votat e pavlefshme (2000-2004)

Tabela 5: Votat e pavlefshme (pesë komunat më të larta/më të ulëta).

Votat e pavlefshme	2000	2004
1 (Zveçan)	10,7%	55,8%
2 (Obiliq)	10,4%	8,7%
3 (Malishevë)	7,1%	3,4%
4 (Dragash)	6,8%	2,4%
5 (F. Kosovë)	6,6%	2,3%
26 (Gjilan)	3,7%	1,0%
27 (Leposaviq)	3,5%	0,9%
28 (Deçan)	3,0%	0,8%
29 (Istog)	2,7%	0,7%
30 (Z. Potok)	2,5%	0,4%

Rënia e votave të pavlefshme mund t'i atribuohet disa faktorëve. E para dhe më e rëndësishmja është fakti që OSBE-ja ndryshoi kriteret se çfarë cilësohet votë e pavlefshme. Një nga këto ishte që votat e zbrazëta të numëroheshin ndaras nga ato të pavlefshmet (që nuk ishte praktikë në vitin 2000). Një arsye tjetër për këtë rënie ishte zgjedhja e sistemit me lista të mbyllura në të cilin është më lehtë të votohet se sa në atë me lista të hapura, që ishte përdorur në vitin 2000.

Në vitin 2000, 4,9% e votave të hedhura ishin të pavlefshme, për të zbritur në 1,9% në vitin 2001 dhe 1,4 në vitin 2004. Ky është një nivel i pranueshëm i votave të pavlefshme, veçanërisht për një demokraci në zhvillim, dhe është një tregues se Kosova tani ka një trup elektoral të edukuar mjaft për të marrë pjesë në një sistem më të komplikuar. Siç tregojnë të dhënat krahasimore, demokraci shumë më të avancuara kanë nivel më të lartë të votave të pavlefshme (p.sh. Sllovenia në vitin 2000 kishte 3,3%, Rumania 6,2%, Polonia në 2001 kishte 4%, etj.) që do të ishte e mjaftueshme si një kompromis për të zgjedhur një sistem zgjedhor që do të sillte përfaqësim dhe llogaridhënie më të mirë. Vazhdimi i edukimit të votuesve do të ndihmonte edhe më tepër në zbritjen e numrit të votave të pavlefshme apo së paku për ta ruajtur brenda këtij niveli të pranueshëm.

Në vitin 2000 Fushë Kosova ka pasur numrin më të madh të votave të pavlefshme

(10,7%), e ndjekur afër nga Shtërpca (10,4%). Në zgjedhjet e po të njëjtit vit, komunat me numrin më të ulët të votave të pavlefshme ishin Istogu (2,5) dhe Artana me (2,7%). Është interesant të përmendet që përveç Zveçanit (me 55,8% vota të pavlefshme), të gjitha komunat tjera kanë ulur dukshëm numrin e votave të pavlefshme në zgjedhjet e vitit 2004. Rënia veçanërisht është e shprehur në Fushë Kosovë, e cila u bë komuna me numrin më të ulët të votave të pavlefshme në vitin 2004. Numri i ulët i votave të pavlefshme ndoshta ka ndodhur për shkak të faktit që Fushë Kosova ka pasur pjesëmarrjen më të ulët të votuesve, duke supozuar që votuesit e disiplinuar dhe relativisht

Numri i vogël i votave të pavlefshme është një tregues që trupi elektor i Kosovës është mjaft i edukuar për të marrë pjesë në një sistem më të komplikuar

të edukuar kanë shprehur të drejtën e tyre, dhe kanë bërë pak gabime.

Edhe pse ka dallime në numrin e votave të pavlefshme në mes të zonave urbane dhe rurale, ato dallime janë tejet të vogla. Rënia e numrit të votave të pavlefshme është e dukshme në tërë Kosovë ashtu siç është në shtatë komunat më të urbanizuara.




Figura 4: Votat e pavlefshme për komunat urbane dhe rurale

4. CILËSIA E PËRFAQËSIMIT

Një ndër treguesit e nivelit të demokracisë në një vend është shkalla e përfaqësimit të qytetarëve, e matur me numrin e qytetarëve që përfaqësohen nga një përfaqësues i zgjedhur.




Figura 5: Përfaqësimi matur sipas përfaqësimit të qytetarëve nga një këshilltar komunal

Në disa prej krahasimeve të bëra hasen shpërputhje të skajshme. Në dy zgjedhjet lokale të mbajtura deri më tani, Prishtina ka qenë komuna me përpjesëtimin më të ulët të përfaqësimit, ku 2.165 votues kanë zgjedhur një deputet, përderisa në Zveçan vëmendja e një përfaqësuesi i ka takuar jo më shumë se 2 votuesve (zgjedhjet lokale të vitit 2000). Ky përpjesëtim është tejet i

padrejtë dhe paraqet shmangie të vrazhdë nga parimi “një person, një votë”, dhe shmangia në fjalë vetëm më vonë është zbutur paksa. Shënimet tregojnë se nga zgjedhjet e dyta lokale 3.044 votues prishtinas janë përfaqësuar nga një këshilltar komunal, përderisa përpjesëtimin më të mirë e gëzon Novobërda ku ka nga një përfaqësues për çdo 163 votues.

Shikuar nga këndvështrimi i përfaqësimit në politikën qendrore, Prishtina del të jetë komuna më përfaqësimin më të favorshëm. Prej 120 deputetëve gjysma prej tyre janë nga Prishtina ose janë vendosur në kryeqytet gjatë viteve të fundit. Pasi që partia paraqet lidhjen kryesore ndërmjet votuesve dhe përfaqësuesve, përqendrimi i këtyre në Prishtinë nuk shihet si diç shqetësuese. Në vend të lëvizjes ndërmjet bazës së tyre zgjedhore, kryeqytetit dhe partisë, shumicës së deputetëve ju mjafton lëvizja ndërmjet selisë së partisë dhe Kuvendit. Meqë në këtë marrëdhënie baza zgjedhore mungon tërësisht atëherë arrijmë në gjendjen me shumicë deputetësh nga Prishtina apo që pas zgjedhjes janë vendosur aty pa pasur ndonjë llogaridhënie të veçantë ndaj kujtdo.

Ndonëse shpërputhja e thellë në përfaqësim (si ajo ndërmjet Prishtinës dhe Novobërdës) tani për tani nuk është burim i ankesave të theksuara, nuk është larg mendjes që në mesin e grupeve me shkallë të ulët të përfaqësimit të fillojmë të shohim rritje të pakënaqësisë. Kjo mundësi bëhet edhe më brengosëse kur marrim parasysh se dallimet në përfaqësim janë më të theksuara nëse ato shikohen me thjerrëz etnike. Në zgjedhjet e vitit 2002 komunat me shumicë serbe mesatarisht kanë pasur 466 votues për çdo deputet, përderisa në komunat me shumicë shqiptare ka pasur një përfaqësues në

1.441 votues. Dallimet e tilla ushqejnë zhgënjimin e shumicës së votuesve kosovarë me sistemin e tanishëm përfaqësues dhe ofrojnë një arsye më tepër për mospjesëmarrje në zgjedhje. Janë grupet e ndryshme të pakicave në komuna të mëdha që përfundimisht ngelin të papërfaqësuar. Nisur nga kjo, është e domosdoshme që ligjet e ardhshme në Kosovë të merret me këtë çështje.

A) Suksesi i partive

Sa i përket efektshmërisë së partive politike, vërehen disa trende të rëndësishme. Siç mund të shihet nga figura 8, LDK-ja në çdo zgjedhje ka pësuar rënie të numrit absolut të përkrahësve të vet krahasuar me zgjedhjet paraprake. Në mes të zgjedhjeve lokale të vitit 2000 dhe zgjedhjeve parlamentare të vitit 2004, LDK-ja ka humbur mbi 85.000 vota. E shprehur në përqindje kjo do të thotë se trupi zgjedhor i LDK-së më 2004 ka qenë për 21,4% më i vogël sesa në vitin 2000. Megjithatë, pas rënies së thellë ndërmjet zgjedhjeve të viteve 2000 dhe 2001 (54.700 vota) dhe asaj ndërmjet zgjedhjeve të viteve 2001 dhe 2002 (23.500 vota), shkalla e rënies së përkrahjes për LDK-në është ngadalësuar. Në zgjedhjet e vitit 2004, LDK-ja ka humbur vetëm 7.481 vota krahasuar me zgjedhjet e vitit 2002.

Mbizotërimi i Prishtinës i shtyn liderët të jenë lojal ndaj klikave të caktuara në qendër, në dëm të legjitimitetit dhe besimit në sistemin politik




Figura 6: Fitimi/humbja e përgjithshme nga subjektet politike

Dy partitë tjera të mëdha, PDK dhe AAK, kanë pësuar ndryshime më të vogla në madhësinë e përgjithshme të përkrahësve të tyre. Përgjithësisht, ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2000 dhe atyre të vitit 2004, PDK ka fituar 11.300 vota (6%). Trupi zgjedhor i AAK-së është rritur për rreth 9,2% krahasuar me vitin 2000. Megjithatë, është me rëndësi të vihet re se në zgjedhjet e vitit 2004 AAK dhe PDK për herë të parë kanë pësuar një rënie të dukshme e që për-pjesëtimisht është më e lartë se sa rënia e pësuar nga LDK.

Këto ndryshime në numrat e përgjithshëm të votave për tri partitë më të mëdha pasqyrohen në proporcionin e votave që mban secila në krahasim me elektoratin në përgjithësi. Pjesëmarrja e LDK-së në numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të vlefshme ka rënë dukshëm më 2001, dhe atë nga 58%, sa ka qenë më 2000, në 43,7%. Nga atëherë e tutje kjo ka mbetur në nivel afërsisht të njëjtë, me lëvizje të lehta ndërmjet 45-

46%, ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2002 deri te ato të vitit 2004.

Rritja absolute e numrit të votave të fituara nga PDK ka rezultuar në shtim prej vetëm 1,5% në numrin e gjithëmbarshtëm të fletëvotimeve të vlefshme nga viti 2000 deri më 2004. Në të vërtetë, PDK në vitin 2001 ka pësuar rënie prej 2,3%, por kjo është përmirësuar në zgjedhjet pasuese më 2002 duke u ngritur në 29% të numrin të përgjithshëm të votave – përqindje kjo më e larta e arritur deri më sot nga PDK.

Një trend shqetësues që vërehet nga shifrat e lartpërmendura është numri i lartë i atyre që nuk marrin pjesë në zgjedhje. Në zgjedhjet e vitit 2000 tri partitë kryesore të atëherëshme mbuluan 70% të gjithë trupit zgjedhor, një përqindje




Figura 7: Performanca e partive kryesore politike dhe abstenuetit nga votimi

kjo e mirë karshi numrit të atyre që nuk votuan e që përbënin vetëm 20%. Megjithatë, ky raport ndryshoi dukshëm në zgjedhjet pasuese në vitin 2001, kur përqindja e partive kryesore ra në 50% ndërsa numri i atyre që nuk morrën pjesë në zgjedhje u ngrit në afër 37%. Në zgjedhjet e vitit 2002, abstenuetit tejkaluan tri partitë kryesore, sado me përparësi shumë të ngushtë (fig. 7) dhe më 2004, tejkaluan madje të gjithë votuesit.

Rritja e numrit të abstenuesve në votim nga zgjedhjet e para lokale më 2000 e tutje mund të shpjegohet pjesërisht me regjistrimin e serbëve dhe të shqiptarëve në diasporë. Regjistrimi dhe mospjesëmarrja e bashkësisë serbe nuk mund të llogaritet për numrin e përgjithshëm të mos votuesve nga arsyeja e thjeshtë se pjesëtarët e bashkësisë në fjalë

nuk mund të paraqesin të gjithë 254.000 abstenuetit në zgjedhje që më 2001 iu shtuan 192.000 abstenuesve nga viti 2000. Në të vërtetë, ndikimi i kufizuar i trupit zgjedhor serb në rritjen e numrit të atyre që nuk morën pjesë në zgjedhje shprehet edhe përmes grafikut të komunës së Kaçanikut, që




Figura 8: Rritja e mosvotuesve në Kaçanik

paraqet shembull të komunës me mjaft pak pjesëtarë pakicash, përderisa edhe këtu trendet e abstenuesve nga votimi janë të ngjashme me pjesët tjera të Kosovës. Rrjedhimisht, rritja e përqindjes së abstenuesve në numrin e përgjithshëm të trupit zgjedhor ka të bëjë pikë së pari me faktorët e ndërlidhur me pakënaqësinë.

B) Suksesi i subjekteve tjera politike shqiptare

Nëse partitë kryesore janë duke humbur kontrollin e tyre në Kosovë, mund vetëm të shpresohet se subjektet e reja do e plotësojnë zbrazësinë. Për fat të keq të gjithë atyre që dëshirojnë të shohin forcim të pluralizmit në Kosovë nuk vërehen trende pozitive me peshë.

Marrë në tërësi, partitë e vogla kanë kaluar më mirë në zgjedhjet lokale, ndërsa më së keqi kanë kaluar në zgjedhjet e vitit 2001. Për dallim nga zgjedhjet e para, më 2004 grumbulli i partive të vogla fitoi 11% të votave, rritje kjo që ka ndodhur si rezultat i hyrjes në garë të nismës qytetare (më vonë partisë politike) ORA, e cila arriti të fitojë 6,2% të votave. Në raport me partitë e tjera politike të madhësisë përafërsisht të njëjtë, PSHDK mbetet më e fuqishme në Gjakovë ku më 2004 fitoj 13,5% të votave. Në po atë vit PSHDK arriti të zgjerojë bazën e vet zgjedhore në Klinë në 9,6%.

Një shembull interesant të oscilimeve të mëdha të votave shihet tek PREK-u. Në zgjedhjet e vitit 2002 PREK fitoi 2,8% të votave, duke u radhitur kështu në krye të listës së partive, pas tri partive më të mëdha. Megjithatë, më 2004 po e njëjta parti arriti të fitojë vetëm 0,1% të votave.

Disa parti dallohen në grupin e partive të vogla. LKÇK, LPK dhe një numër i partive të tjera përgjithësisht shikohen si jo aq konstruktive ndaj sistemit të tanishëm të qeverisjes dhe opsioneve që mbrojnë për statusin e ardhshëm. Ato, për dallim nga partitë e tjera politike, angazhohen për bashkim me Shqipërinë. Në vitin 2000, këto parti fituan 0,18% të votave. Kjo paraqet përqindjen më të ulët të votave që këto parti kanë marrë krahasuar me zgjedhjet e tjera të mbajtura deri




Figura 9: Votat e partive që përkrahin bashkimin me Shqipërinë

më tani. Në vitin 2001 rezultatet e këtyre partive të marra si tërësi janë rritur në 2%, përqindja kjo më e lartë e votave që partitë në fjalë deri më tani kanë fituar. Në të njëjtin vit performansa më e mirë është shënuar nga LKÇK, që fitoi 1,1% të votave në mbarë Kosovën. LKÇK kaloi më së miri në Suharekë/Therandë (3,6%), Ferizaj (1,7%) dhe Rahovec (1,6%). Në zgjedhjet e fundit (2004) LKÇK nuk morri pjesë fare. Përgjithësisht, përfaqësimi i partive politike të profilit në fjalë është i konsoliduar në rreth 1,3%.

C) Shpërndarja gjeografike e votave

Në nivelin mbarë-kosovar pothuajse nuk ka ndarje të dallueshme të votimit ndërmjet pjesëve urbane dhe atyre rurale, ndonëse disa dallime të vogla mund të vërehen. Megjithatë, në shumicën e komunave është e mundur që të vërehet një trend rajonal i shpërndarjes së votave, i përqendruar kryesisht përreth grumbujve të fshatrave. Përderisa dy partitë kryesore në nivel të komunës në Malishevë mbajnë fuqi të barabartë, ka pak rajone në të cilat trendet zgjedhore përcjellin trendet e përgjithshme komunale. Shumica e qendrave të votimit kanë raportuar për trende në të cilat një parti kontrollon së paku 60% të votave. Sipas hulumtimeve të bëra, votimi në Malishevë në masë të madhe bëhet në vartësi të përkatësisë familjes Kastrati apo Krasniqi, familje këto me rivalitet të gjatë në këtë rajon. Mbizotërimi i PDK-së në qytezë është i qartë, me 62% të votave, para LDK-së që ka 27% të votave, ku kjo e fundit ngecjen karshi PDK-së e zbutë me fuqinë që gëzon në shumicën nga pjesët fshatare të komunës.

Një model tjetër e sjelljeve votuese ilustron mirë nga rasti i Klinës, ku votuesit ndjekin përkatësi të tjera gjeografike. Në pjesët rreth Drenicës, PDK është më e fuqishmja, duke gëzuar rreth 50% të votave, dukshëm më tepër se sa në nivelin gjithë-komunal. Ngjashëm me këtë, AAK-ja qëndron më mirë në pjesët të cilat kufizohen me komunën e Pejës, në qendrat e votimit në Grabanicë dhe Drenoc mbi 20%, më shumë se sa mesatarja e saj për mbarë komunën. Me të njëjtën logjikë, PSHDK ka marrë 38% në Zllakuqan, 24% në Budisallc, dhe 13% në qytezën e Klinës, krahasuar me 1,8% që ka marrë në nivelin gjithë-kosovar.

Modeli i tretë që del në pah është ai i Prishtinës, ku dallimet qytet-fshat qojnë peshë të konsiderueshme. Për dallim nga komunat e tjera, në këtë rast LDK është relativisht e fuqishme në mbarë pjesët fshatare të komunës duke pasur këtu 61% të votave krahasuar me pjesën urbane LDK ka 51%. Përkrahje më të fuqishme në pjesët fshatare gëzon edhe PDK. Kjo parti ka fituar 21% të votave jashtë qytetit dhe 18% brenda, trend ky i njëjtë edhe për AAK-në. Dobësia relative e tri partive më të mëdha në pjesët urbane të Prishtinës vjen pjesërisht si pasojë e daljes në skenë të ORA-s e cila padyshim se në shënjestër të fushatës së vet ka pasur popullsinë urbane. Si rezultat, ORA ka arritur të fitojë ndërmjet 13%-25% të votave në qytet, 6% në periferi të afërt, si Kodra e Trimave apo Hajvali, ndërmjet 4%-5% në fshatrat fqinje si Besi apo Shkabaj, për të fituar vetëm 1% në pjesët më të largëta si Sharban apo Marevc.

Votat e përcaktuara nga përkatësitë individuale, vijat e ndarjes nga koha e luftës, lidhjet familjare, paragjykimet qytet-fshat nuk janë të shëndosha dhe ato duhet tejkaluar

Komuna e Kaçanikut paraqet gërshetim të dy trendeve, atij të trashëgimisë së luftës dhe si këto ndasi reflektohen në trende zgjedhore. Për më tepër, është interesante se si në Kaçanik këto ndarje në masë të

madhe përputhen me bindjet parokiale të “banorëve të vjetër të Kaçanikut” karshi ardhacakëve nga pjesët fshatare. Përderisa në vetë qytezën e Kaçanikut shumica ka votuar për LDK-në, gjegjësisht 49% krahasuar me 36% sa ka fituar PDK, kjo e fundit ka qenë në shumicë kryesisht nëpër pjesët rurale.

Një shpërndarje gjeografike e këtillë, siç përshkruhet në paragrafët me lartë, e përcaktuar nga përkatësitë individuale, ndasitë e lidhura me luftën, lidhjet familjare, paragjykimet urbane-rurale nuk janë të shëndosha dhe ato duhet tejkaluar. Në vend të manipulimit të këtyre vijave të ndarjes, partitë duhet të bëjnë përpjekje që t'i tejkalojnë. Gjithashtu, duhet pasur parasysh se rëndom në hapësirat me veçori të tilla veprojnë degë të fuqishme të partive e të cilat shpeshherë mund të jenë rrjedhojë e marrëdhënieve të përshkruara më lartë. Tejkalimi i këtyre marrëdhënieve jo vetëm që është i rëndësishëm për partitë, por ai është edhe qenësor nëse dëshirohet që Kosova t'i braktisë ndarjet e tanishme e të bëhet shoqëri kosmopolite, ndonëse trendet në fjalë edhe ndër demokracitë perëndimore vazhdojnë të jenë të pranishme në shkallë të ndryshme.

D) Partitë lokale

Janë disa parti lokale të kufizuara gjeografikisht e që veprojnë në komuna të ndryshme. Ndër këto, partia më e njohur është Unioni Demokratik i Gjakovës (UDGJ), parti kjo e përqendruar brenda Gjakovës. Megjithatë, përkundër karakterit të saj lokal, UDGJ morri pjesë edhe në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2004 dhe ka arritur të fitojë numër simbolik të votave në shumicën e komunave. Në zgjedhjet lokale të vitit 2002 UDGJ fitoi 2,3% të votave në Prizren, përderisa në selinë e saj (Gjakovë) arriti të fitojë 7%, përqindje kjo e mjaftueshme për të siguruar tri vende në Kuvendin Komunal.

Ndër komunitetet tjera janë dy parti tjera lokale, Iniciativa Qytetare e Gorës (GIG) dhe Iniciativa Prizren-Dragash (PDI). Përderisa GIG morri pjesë në zgjedhjet e vitit 2000, 2000, 2002 dhe 2004, PDI morri pjesë vetëm në zgjedhjet e vitit 2004. Pasi që të dy këto parti përbëhen nga pjesëtarë të bashkësisë gorane dhe në shënjestër të tyre është baza zgjedhore e kësaj bashkësie etnike atëherë edhe prania e tyre territoriale është e përqendruar kryesisht në Dragash dhe Prizren. Në zgjedhjet e para lokale, GIG ka fituar 12% të votave në Dragash duke marrë dy vende në kuvendin komunal. E njëjta parti në Prizren ka fituar 2,8% dhe 0,3% në Mitrovicë. Në zgjedhjet e vitit 2004, GIG ka fituar 14% të votave në Dragash, 3,8% në Prizren dhe më pak vota në disa komuna të tjera. PDI morri pjesë në zgjedhjet e vitit 2004, por suksesi i saj ishte i ulët, duke arritur që në Prizren të fitojë vetëm 1,8% të votave.

Si pasojë e bojkoteve të shumta të serbëve është e pamundur që të nxirren çfarëdo trendesh të votimit të kësaj bashkësie, së pari në zgjedhjet e vitit 2000 kur ata bojkotuan edhe vetë regjistrimin për zgjedhje, e deri tek pjesëmarrja e pjesërishme në zgjedhjet

pasuese. Pjesëmarrja më e lartë e serbëve është shënuar në zgjedhjet lokale të vitit 2002 kur përfaqësuesit e zgjedhur serbë fituan kontrollin në pesë komuna të Kosovës.

Është interesante për të vënë në pah se skena politike serbe është shumë më plurale sesa ajo e shqiptarëve. Përderisa

partitë lokale të shqiptarëve asnjëherë nuk kanë arritur të fitojnë më shumë se 1% të numrit të përgjithshëm të votave, pandanët e tyre serbë kanë kaluar shumë më mirë brenda kampit serb. Ngjashëm me këtë, edhe nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur kanë kaluar më mirë brenda bashkësisë në fjalë.



Figura 10: Shpërndarja e votave të serbëve

5. A PO ZBEHET LEGJITIMITETI?

A) Legjitimiteti i partive politike dhe sjelljet zgjedhore

Demokracia e re dhe e brishtë e Kosovës me sistemin zgjedhor të tanishëm mbështetet në përfaqësim sipas listave të mbyllura. Udhëheqësit partiak kanë fjalën e fundit për atë se kujt i sigurohet vendi në parlament e kush mbetet jashtë. Çështjet që kanë të bëjnë me llogaridhënien, ndëshkimin apo shpërblimin e përfaqësuesve individualë në këtë mënyrë vihen në diskrecion të plotë të kreut të udhëheqësisë partiake. Për më tepër, që

Tabela 6: Opozita kryesore po fiton

	LDK	PDK	AAK
Deçan	-926	-275	3.122
Gjakovë	-9.442	-238	2.007
Drënas	-438	-1.274	211
Gjilan	-2.890	1.769	-33
Kacanik	841	-659	-56
F. Kosovë	-138	757	-681
Klinë	-1.867	114	648
Mitrovicë	-5.269	2.778	767
Lipjan	-795	1.966	-269
Obiliq	-344	459	-1.426
Rahovec	-5.108	1.500	-1.854
Pejë	-7.985	-332	5.741
Podujevë	-3.470	906	-1.135
Prishtinë	-11.367	2.366	-1.014
Prizren	-12.058	2.541	815
Suharekë	-4.077	2.105	-425
Ferizaj	-2.395	1.571	837
Viti	-1.420	496	257
Vushtrri	-2.114	875	-4
Malishevë	-1.383	2.391	150
Legjenda:	Pozita	Opozita kryesore	Opozita
	-5.269	2.105	2.383

të gjitha këto dhe veprimet e tjera të ngjashme nganjëherë shihen si barrë të cilën udhëheqësit partiakë mund të mos kenë interes apo mundësi për ta ushtruar si duhet ndaj pretendentëve për përfaqësues të zgjedhur. Në vend të kësaj, udhëheqësit partiak shpeshherë e gjejnë vetën duke baraspeshuar ndërmjet fraksioneve të ndryshme që kanë përbrenda partisë. Brenda një ambienti të tillë nuk është për t'u çuditur kur dëgjoen edhe pohime për shantazhime që anëtarë të ndryshëm u bëjnë udhëheqësve partiakë e me qëllim të përfshirjes në listë zgjedhore.

Përveç kësaj, përfaqësuesit e zgjedhur shohin pak arsye bindëse për t'u qenë mirënjohës votuesve për zgjedhjen e tyre. Pa dyshim, ata ndejnë vetën shumë më në borxh para krerëve të partisë së tyre. E kuptueshme, përfaqësuesit, si krijesa të arsyeshme, e dinë më së miri se cilat janë interesat e tyre dhe ata nxiten në sjelljet e tyre nga dëshira për t'u zgjedhur dhe rizgjedhur. Por, përderisa votuesit nuk figurojnë në radarin e përfaqësuesve, këta të fundit vështirë se do të mund të dinë se çfarë është më mirë për ata të cilat do të duhej ti përfaqësonin. Zgjedhja dhe rizgjedhja e tyre, ndonëse e ndikuar nga numri i përgjithshëm i vendeve që fiton partia e caktuar, me këtë sistem zgjedhor është krejtësisht e pandikuar nga pesha politike që kandidati i caktuar i sjell partisë.

Kuptohet se rregullimet e tilla zgjedhore janë në dëm të qytetarëve dhe të besimit të tyre në institucionet demokratike. Rëndom qytetarët shprehin parapëlqimet e tyre mbështetur në vlerësimet për udhëheqësit partiakë, përfaqësuesit lokalë dhe një numër faktorësh të tjerë, të cilët i gjykojnë të jenë të rëndësishëm. Ata gjykojnë punën në të kaluarën dhe atë çfarë presin në të ardhmen. Të përfaqësuarit gjithashtu llogarisin të kenë ndikim të caktuar ndaj përfaqësuesve të tyre. Ndikimi i qytetarëve nuk nënkupton kontroll të plotë ndaj asaj që përfaqësuesit bëjnë dhe thonë, por së paku një ndjenjë të mundësive më të gjëra për të zgjedhur si dhe për të ndëshkuar ata që i shmangen interesit publik. Në rastin tonë, mungesa e marrëdhënieve personale ndërmjet të zgjedhurve dhe votuesve bie ndesh me pritjet minimale të qytetarëve. Të mbetur pa ndikim në përcaktimin se kush mund të jenë përfaqësuesit e tyre më të mirë, votuesit po refuzojnë atë që u ofrohet, pasi që e gjejnë vetën në gjendje nga e cila nuk mund të rrezikojnë kandidatët të cilët tradhtojnë interesin publik. Bazat zgjedhore po bëhet gjithnjë e më apatike ndërsa besimi në institucionet demokratike po zbehet. Prania e një numri të organeve ekstra-kushtetuese (UNMIK-u) që veprojnë tërësisht jashtë hapësirës së ndikimit të votuesve, vetëm sa e rritë ndjenjën e pafuqisë dhe e shton deficitin në legjitimitet.

Ky këndvështrim nuk do të ishte aq dekurajues sikurse partitë politike – që tani për tani paraqesin hallkën e vetme ndërmjet përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve – nuk do të ishin aq neglizhente karshi abstenimit zgjedhor. Për fat të keq, deri më tani nuk hasen përpjekje brenda partive për adresimin e kësaj çështjeje. Në të vërtetë, indiferenca brenda partive në lidhje me pjesëmarrjen e ulët në zgjedhje shprehet edhe në një varg deklaratash pas-zgjedhore të udhëheqësve kryesorë partiakë.

B) “Ne dimë më mirë se votuesit”

Shumë udhëheqës vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe kreutë të partive, arsyetonin listat e mbyllura me argumentin se partitë janë ato që më së miri e dinë se cilët janë kandidatët më meritore. Përgjatë vijave të kësaj mënyre të të menduarit, PSSP (Harri Holkeri) paradoksalisht refuzoi t’i hapë listat duke deklaruar se ato favorizojnë personat e famshëm. Në të vërtetë, sistemi i tanishëm forcon vetëm udhëheqësinë e secilës parti, përderisa një sistem ndryshe do u shërbente qëllime të zgjedhjeve, gjegjësisht fuqizimit të atyre që më së shumti interesohen për shqetësimet e qytetarëve. Që të dy argumentet e bëra nga përkrahësit e sistemit me lista të mbyllura partiake nisen nga supozimi se kosovarët janë të paaftë të marrin vendime inteligjente dhe të përgjegjshme për vetën e tyre. Kjo nënkupton bindjen që zgjedhjet duhet të shërbejnë vetëm si fasadë, përderisa vendimmarrja vazhdon të mbetet e kontrolluar nga një grusht i udhëheqësve partiakë, e jo nga votuesit. Një mënyrë e tillë e të menduarit jo vetëm që është shuplakë për procesin e demokratizimit, por është edhe e pasaktë. Siç shqyrtohet

në këtë punim, votuesit kosovarë kanë ndërruar lojalitetin kur kanë qenë të pakënaqur me udhëheqësit e tyre. Kështu duket të jetë në nivelin lokal – ku votuesit shohin prova të mjaftueshme për të gjykuar punën e politikanëve lokalë dhe për të dhënë votën në përputhje me ato prova. Megjithatë, vënia e procesit vendimmarrës tërësisht jashtë sferës së ndikimit qytetar, ashtu siç është kjo me sistemin zgjedhor të tanishëm, i bën qytetarët të pakënaqur me mbarë procesin politik dhe me elitën politike. Kjo i bën votuesit të pashpresë me rregullat e lojës të padrejta dhe jodemokratike, si dhe me politikanët jashtë ndikimit të tyre. Në rast se kjo nuk adresohet, atëherë do të ketë më shumë hapësirë për udhëheqës joformal dhe për shtigje negative të shprehjes së pakënaqësisë.

Zbehja e legjitimitetit më parë është shtruar si çështje brengosëse në një varg raportesh dhe nga shoqëria civile. Duke vërejtur aftësitë e kufizuara për të udhëhequr, një nismë të gjerë të pjesëtarëve nga shoqëria civile ka kërkuar një sistem zgjedhor me lista të hapura në njësi zgjedhore me më shumë përfaqësues. Qëllimi i këtij propozimi ishte fuqizimi i udhëheqësve afër popullit sikundër edhe krijimi i hapësirës më të gjerë për individët më ndikim të cilët mund të mobilizojnë masat ndonëse nuk janë pjesë e strukturave politike zyrtare. Disa nga individët e tillë mund të shihen si radikalë, por vetë parimi i stabilizimit pas luftës është shprehja e shqetësimeve nga të gjithë politikanët në Kuvend sesa në rrugë. Ndërmjet interesave praktike të politikës ditore në njërën anë dhe legjitimitetit në anën tjetër, kjo e fundit do të duhej të ketë përparësi.

Arsyetime i listave të mbyllura mbështetet mbi supozimin se kosovarët janë të paafte që të marrin vendime të përgjegjshme për vetën e tyre

C) Ndëshkimi i bartësve të pushtetit

Një vështrim i kujdesshëm i trendeve zgjedhore tregon se votuesit janë shumë më inteligjent sesa që politikanët apo UNMIK-u mendojnë. Partitë të cilat kanë kontrolluar qeveritë e ndryshme komunale ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2000 dhe 2002 kanë humbur mbi 80.000 vota. Ky fakt vë në pah pakënaqësinë e përgjithshme me të gjitha partitë në pushtet (lokal) sikundër edhe identifikimit gjithnjë e më të madh të votuesve me çështjet lokale. Votuesit në mënyrë inteligjente dhe të vetëdijshme po reagojnë në përputhje me peshën e perceptuar që institucionet e caktuara kanë për shqetësimet dhe interesat e tyre. Mund të shtohet madje se reagimi i tyre sipas të gjitha gjasave është në korrelacion me sasinë e informatave nga dora

Ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2000 dhe atyre të vitit 2002, qeveritë lokale nëpër komuna kanë humbur vota, përderisa opozita lokale ka fituar, pavarësisht se cila parti ka kontrolluar pushtetin

e parë që ata kanë për punën e përfaqësuesve. Refuzimi për t'i dhënë serish votën bartësve të pushtetit dhe shtimi i votave për opozitën lokale është shenjë se votuesit janë mjaft të pakënaqur me mënyrën se si është qeverisur komuna gjatë periudhës së caktuar. Bartja e votës së tyre tek partia e dytë për kah madhësia lë të kuptohet se jo vetëm që votuesit ndëshkojnë bartësit e pushtetit për rezultatet e pakënaqshme, por edhe besojnë se qeverisja më e mirë është e mundur. Kjo shpresë, e shikuar në raport me rritjen e abstenimit nga zgjedhjet dhe fletëvotimeve të zbrazëta, duket një rënie e ngadaltë, por e sigurt.

Në vend të votimit të vakët për opozitën, shumica e votuesve kanë zgjedhur për të mos votuar fare

Përgjithësisht, partitë në pushtet në nivelin lokal ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2000 dhe 2002 kanë humbur 82.144 vota në mbarë Kosovën, përderisa partitë opozitare kanë fituar 30.049 vota. Kjo lë një grup prej 50.000 deri në 110.000 “të papërcaktuar”, gjë që do të thotë se shumica e votuesve në vend se nga frustrimi të votojnë për opozitën, kanë vendosur që të mos votojnë fare. Përderisa partia e dytë për kah madhësia, në nivelin gjithë-kosovar (PDK) ka fituar vota në komunat ku ka qenë në opozitë, e njëjta ka humbur në

Tabela 7: Humbjet dhe fitimet bazuar në pozitën kundrejt pushtetit

	Pozita	%	Opozita e parë	%	Opozita e dytë	%
Kombinuar	-81.884	-11,9%	34.217	4,3%	-2.990	-0,4%
LDK	-78.800	-19,8%	554	0,14%	n/a	n/a
PDK	-3.084	-1,64%	22.793	12,14%	-845	-0,45%
AAK	n/a	n/a	10.870	5,36%	-2.145	-1,06%

komunat ku e ka pasur pushtetin në duart e veta. Rrjedhimisht, trendi i pakë-

naqësisë vlen për të gjitha partitë që janë në pushtet në nivelin lokal, e jo vetëm për LDK-në. Marrë në përgjithësi, trendet në fjalë tërheqin vëmendjen në humbje serioze të besimit ndaj partive politike kosovare.

Mbi të gjitha, perceptimi i votuesve se u mungojnë mjetet përmes të cilave do të ushtronin ndikim ndaj përfaqësuesve dhe t'i sanksiononin të njëjtit është çështje që duhet trajtuar. Qytetarët meritojnë të kenë ndikim në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre individualë dhe në pajisjen e këtyre të fundit me mandate zgjedhore. Duhet siguruar kanale më të mira të llogaridhënies së drejtpërdrejtë në mënyrë që disponimi të kuptohet drejt dhe me qëllim të shndërrimit të duhur të së njëjtës në agjendë parlamentare. Menaxhimi i përzgjedhjes së kandidatëve vetëm sipas parapëlqimeve të udhëheqësve partiakë pamundëson marrëdhënie dinamike të përgjegjshme ndërmjet votuesve dhe përfaqësuesve. Në të njëjtën kohë shpresohet se kjo do të përmirësonte asimetrinë lidhur me informatat për kandidatët gjë e cila tani për tani shkon në dëm të qytetarëve.

D) Pushteti lokal po humb, përderisa opozita lokale po fiton

Siç u përmend më lart, ndërmjet zgjedhjeve të vitit 2000 dhe atyre të vitit 2002, partia në pushtet në shumicën prej komunave ka humbur vota, pavarësisht se cila parti ka qenë në pushtet.

Në tabelën 6, numrat në bold në kuti të bardha tregojnë rezultatet e partisë që ka kontrolluar pushtetin, përderisa rezultatet në pjesën e hijezuar tregojnë partitë që kanë qenë në opozitë. Për shembull, partia kryesore në Kosovë, LDK, ka humbur vota në secilën komunë ku ka pasur pushtet ndërmjet dy viteve (shih komunat e Prishtinës, Gjilanit, Vushtrrisë, Suharekës, Podujevës, etj.), ka humbur mesatarisht 3.210 vota për komunë. Ky trend i njëjtë, ndonëse në një shkallë pak më të lehtë, ka përcjellë edhe PDK-në, e cila ka humbur vota në tri nga katër komunat ku ka pasur shumicën (Drenas, Skenderaj dhe Kaçanik).

Një shpjegim i mundshëm pse votuesit po largohen nga pozita është ndjenja për mos shprehjen e interesave të tyre nga partitë. Në vend se të shohin votuesit e tyre si burim kryesor të pushtetit, partitë janë përqendruar në vendosjen e kontrollit mbi organet ekzekutive të niveleve të ndryshme. Argumentet e prezantuara këtu vejnë në pah se votuesit po i kuptojnë dhe po reagojnë ndaj përqendrimit të këtillë afat-shkurtër të partive dhe në numër gjithnjë e më të vogël po votojnë për partitë në pozitë nëpër komunat e tyre.

E) Nuk është duke fituar e gjithë opozita

Ndonëse opozita është duke fituar vota, kjo nuk vlen për të gjitha partitë në opozitë. Në të vërtetë, është vetëm partia kryesore opozitare në nivelin komunal që ka trend të fitimit, përderisa partia e dytë në opozitë sikurse edhe partia në pushtet është duke humbur vota. P.sh.,

LDK në Gjakovë ka humbur vota, por votat nuk janë shtuar për PDK-në si parti kryesore opozitare në nivelin gjithë-kosovar, por për AAK-në, partinë kryesore opozitare në komunë. Po i njëjti trend vlen edhe për komunat fqinje të rrafshit të Dukagjinit ku udhëheqësia e tanishme e AAK-së ka qenë aktive gjatë rezistencës së armatosur nga fundit i viteve '90 (Gjakovë, Deçan, Klinë, Pejë) dhe kjo paraqet hapësirën e vetme ku ajo ka pësuar rritje përmbajtësore. Ngjashëm, PDK ka shtuar radhët e veta në mbarë



Figura 11: Trendet e votimit bazuar në madhësinë e opozitës

Kosovën, jashtë rrafshit të Dukagjinit, ku ka qenë partia kryesore në opozitë (Gjilan, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë). Përderisa të dhënat e disponueshme janë të pakta për shpjegime përfundimtare, trendet në fjalë mund të shihen si sanksionim i kombinuar i pushtetit kur qytetarët janë të pakënaqur me rezultatet e atij pushteti.

F) Atëherë, politika lokale çon peshë

Duke shikuar të dhënat si ato të lartpërmendurat në Prizren, në Mitrovicë apo Rahovec zbulohet më shumë se një trend. Jo vetëm që votuesit në zgjedhjet lokale gjithnjë e më shumë po votojnë për opozitën lokale, por kjo mënyrë e të menduarit po ka ndikim edhe në preferencën e tyre për zgjedhjet qendrore. Është me rëndësi për të pasur parasysh se zgjedhjet qendrore po përcjellin trendin e ndikuar nga dinamika lokale. Zgjedhjet qendrore (kolona e dytë dhe e katërt në figurë) kanë mbetur në nivel të tren-deve të përcaktuara nga zgjedhjet e viteve 2000 dhe 2002. Nga kjo, tërthorazi mund të shihet se një numër i qytetarëve kanë dhënë votën e tyre për zgjedhjet qendrore

Mënyra lokale e të menduarit gjithnjë e më shumë po ka ndikim në zgjedhjet e nivelit qendror

mbështetur në perceptimet e tyre për punën e partive në nivelin lokal. Një shpjegim i mundshëm për këtë trend është asimetria informative ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal. Përderisa kontaktet me nivelin qendror janë të pakta jashtë fushatës zgjedhore, në rast të përfaqësuesve zgjedhorë gjërat qëndrojnë ndryshëm.

Vetë afërsia e organeve lokale ofron më shumë mundësi për vlerësime të informuara. Rrjedhimisht, zbrazësitë në informata për punën e partive në qendër gradualisht plotësohen me informata të disponueshme nga niveli lokal.

Mënyra e përgjithshme e të menduarit në Kosovë anon kah trajtimi i zgjedhjeve komunale si diç që nuk ka peshë të madhe. Ka shembuj të shumtë se si Prishtina ka ndikuar dhe dëmtuar politikën lokale (për një diskutim të gjerë të qeverisjes lokale në Kosovë, shih “Qeveria dhe administrata lokale në Kosovë botuar nga KIPRED-i më 2004). Prishtina zakonisht ka paracaktuar partnerin e koalicionit kurdo që kjo ka qenë e mundur dhe shpeshherë ky ka qenë faktori vendimtar në rastet e garave për pushtet ndërmjet klikave të ndryshme brenda partive. Siç tregon hulumtimi ynë, kalkulimet e qendrës rreth asaj se cilën klikë duhet përkrahur, zakonisht janë mbështetur në kalkulimet rreth departamenteve më fitimprurëse apo bazuar në politikat mbarë-kosovare të partisë. P.sh.

Kanalet e pakënaqshme të komunikimit brenda-partiak dhe vendimmarrja demokratike e pamjaftueshme kanë shkaktuar shkëndija brenda të gjitha partive kryesore




Figura 12: Trendet zgjedbore në komunit e zgjedhura si mostër

të fitojë përkrahjen e nevojshme për të siguruar pozitën e kryetarit të komunës, edhe përkundër presionit të fuqishëm dhe ndërhyrjeve të drejtpërdrejta nga qendra. Ngjashëm, në njerën nga bazat e saj më të fuqishme (Drenas), PDK është detyruar të kapërdijë pakënaqësinë e vet dhe të tolerojë udhëheqësinë e re të degës së partisë. Në një rast tjetër të ngjashëm, në degën e Podujevës ka pasur pakënaqësi të thella brenda njëres nga partitë kur 14 nga 18 nëndegët kanë kërkuar mbledhjen e kuvendit të degës, ndonëse kjo nuk ndodhi për shkak të ndikimit të fraksionit mbizotërues nga qendra. Këto kritere për krijimin e koalicioneve nuk mund të kalojnë pa u vërejtur në një vend të vogël si Kosova, dhe kjo ka pasur për pasojë thellimin e pakënaqësisë dhe humbjen serioze të votuesve për këto parti.

Politika lokale po ndikon në përkatësitë politike, por kjo mund të mos jetë për shkak se kosovarët kanë filluar të vendosin mbështetur në çështje të politikave, por ndoshta për shkak se ky është imazhi më i afërt i votuesve që ata e shohin. Degët e partive lokale janë më të afërta me qytetarin e ky i fundit aty sheh më shumë dëshmi të keq-menaxhimit. Vendosmëria në zbehje e sipër e udhëheqësve partiakë si faktorë dhe disbalanci informativ ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal po e shtyn politikën lokale në qendër të vëmendjes së votuesve.

Çështja ende mbetet pse më shumë vota nuk kaluar te partitë e tjera?! Arsyet kryesore

dega e LDK-së në Klinë ka pasur koalicion pune me PDK-në, por pas ndërhyrjes nga qendra, e njëjta është detyruar të lidhet në aleancë me PSHDK-në për të bërë qeverinë lokale. Huluntimet tona nga terreni tregojnë për shembuj të shumtë kur partitë në koalicion kanë kushtëzuar partneritetin e tyre me marrjen e departamentit të caktuar, si b.f. atij të rindërtimit.

Kanalet e pakënaqshme të komunikimit brenda-partiak dhe vendim-marrja demokratike e pamjaftueshme kanë shkaktuar fërkime brenda të gjitha partive kryesore. Në Ferizaj, përpjekja e kryetarit të atëhershëm të komunës (i zgjedhur për zëvendës-kryeministër) të zgjedhë pasuesin e tij nuk ka pasur sukses. Në të vërtetë, është paraqitur një kandidat tjetër nga e njëjta parti (LDK) dhe i njëjti ka arritur

për këtë duket të jenë: (a) mungesa e alternativave serioze, dhe (b) perceptimi i lojalitetit partiak si ballafaqim i klaneve me pozitat deri diku të çimentuara të atyre që tanimë janë në pushtet, dhe të atyre që më shumë janë të interesuar të shohin të afërmit e tyre në pushtet sesa të sigurojnë disa përfitime afatgjata për vete.

G) Tani mos-votuesit janë “partia” më e madhe

Fakti se shumica e votuesve të pakënaqur po tërhiqen në “kampin e të pavendosurve” dhe mund të paraqesin grup që mund të ndikojnë në fitim zgjedhesh shihet përmes krahasimit të votave të të gjitha partive me numrin e qytetarëve të cilët po zgjedhin për të mos votuar fare. Përderisa më 2000 mos-votuesit kanë qenë afërsisht të njëjtë në numër sikurse partia e dytë për kah madhësia, më 2002 mos-votuesit paraqitën trup të votuesve dy herë më të madh sesa partia më e madhe. Me mungesën kronike të shtigjeve alternative të ligjshme, gjasat për pjesëmarrjen pozitive të kosovarëve në vendim-marrjen publike janë tejet të zbehta. Ata thjesht po ndjehen gjithnjë e më pafuqishëm dhe të tëhuajësuar nga sistemi. Tundimi i tyre për të mos votuar në vend se të ndryshojnë preferencat e tyre të mëhershme paraqet shprehje të mosbesimit në sistem. Asnjë sistem nuk mund t’ia ofroj vetës luksin e injorimit të shprehjeve të kësaj natyre.

H) Mungesa e alternativave

Mbështetur në atë që u tha më lart mund të fitohet përshtypja se partia e dytë për kah madhësia është në gjendje më të mirë. Fakti se rënia e PDK-së është më e lehtë apo se ngritja e përgjithshme është më e dukshme sesa te LDK-ja mund të shpjegohet me faktin se PDK ka qenë në opozitë në shumicën e komunave.

Fakti se PDK-ja shënon një trend më të butë nuk dihet nëse rrjedh nga të qenit parti më e parapëlqyer sipas veprimeve të saj. Të dhënat tërheqin vëmendjen në faktin se kjo mund të jetë rezultat i asocimit me opozitën kryesore në nivelin gjithë-kosovar, me rëndësi për votuesit për të cilët politika në nivelin kosovar është më e rëndësishme se sa ajo e nivelit lokal. Fakti se PDK ka humbur në komunat ku ajo ka pasur shumicën tregon se perceptimi tyre si opozitë në nivelin gjithë-kosovar nuk mjafton në pjesën ku të njëjtit mbajnë pushtetin. Ndonëse PDK-ja shpeshherë është pozicionuar si parti opozitare, deri në zgjedhjet e vitit 2004, ajo ishte pjesë e qeverisë, fakt ky që mund të shpjegoj pse nuk pati më shumë votues që kaluan në radhët e saj.

Shenjat e ndëshkimit të partive që mbajnë pushtetin në nivelin lokal tregojnë se jo vetëm që politika lokale çon peshë, por edhe se e njëjta është faktor vendimtar për ndryshimin e votave në zgjedhjet pas vitit 2000. Megjithatë, e meta e kësaj është se si pasojë e mungesës së alternativave, shkopi që votuesit posedojnë për të ndëshkuar

Partitë më të vogla të cilat nuk kanë arritur sukseset e pritura ,ankohen se trupi zgjedhor kosovar është shumë i ngurtë dhe se votuesit janë mësuar të votojnë për prijësit kryesorë dhe se nuk u kushtojnë vëmendjen ofertave të mirëfillta që vijnë nga partitë e tjera

udhëheqësit është tejet i vogël. Në të njëjtën kohë rigjiditeti i votuesve zvogëlon gjasat për ndryshime të mëdha në vota në favor të partive të vogla, ndërsa i shton gjasat për të mos votuar fare.

Edhe më shqetësuese, fakti se PDK është duke humbur në terrenin e vet paraqet shenjë se votuesit janë të pakënaqur me ta. Kjo është shenjë se aty ku PDK-ja ka fituar vota, ato vota të atyre të cilët janë dëshpëruar me të tjerët, gjë që sipas të gjitha gjasave është ngjashëm edhe me ish votuesit e PDK-së që më pas kanë vendosur të votojnë për LDK-në,

AAK-në apo të mos votojnë fare. Në rast se ky trend vazhdon, votuesit në gjithë komunat i pret një deziluzionim serioz.

1) Votuesit nuk shkojnë vetëm pas udhëheqësve të mëdhenj, por edhe pas politikës së suksesshme lokale

Shpeshherë analistët të cilët dëshirojnë të shohin votues më dinamikë që më shpejt reagojnë ndaj efektshmërisë së partive, e rrjedhimisht që në afat të gjatë t'i bëjnë partitë më llogaridhënëse, ankohen se votuesit votojnë për udhëheqësit kryesorë. Partitë më të vogla të cilat nuk kanë arritur sukseset e pritura po ashtu ankohen se trupi zgjedhor kosovar është shumë i ngurtë dhe se votuesit janë mësuar të votojnë për prijës kryesorë, ndërsa si pasojë e kësaj ofertat e mirëfillta të bëra nga partitë e tjera nuk arrijnë deri tek votuesit. Kjo mund të ketë qenë e vërtetë menjëherë pas luftës kur votuesit shpërblenin dy lëvizjet kryesore të lidhura me rezistencën e viteve nëntëdhjetë apo me luftën e armatosur. Një shpjegim tjetër i mundshëm është se oferta alternative nuk ishte mjaft bindëse, apo se nuk ishte bërë nga personat e duhur. Fakti se pushteti i udhëheqësve të tanishëm është padyshim duke u zbehur, siç vërehet jo vetëm përmes numrave të përmendur më lartë, por edhe nga paaftësia e udhëheqësve për të zmrapsur dhunën e mëhershme, nga shtimi i pakënaqësisë siç shihet ajo brenda shoqërisë civile, sikundër edhe nga trendi i pjesëmarrjes së ulët i protestuesve kur protestat ftohen nga udhëheqësit kryesorë. Këto trende vejnë në pah zbehjen e shpejtë të legjitimitetit të udhëheqësve politikë.

Bashkësia ndërkom-bëtare duhet të insistojë që në Kosovë të zë vend demokracia e mirëfilltë, dhe jo t'u japë kurajo udhëheqësve që në rend të parë të përkujdesen për detyrimet ndaj bashkësisë ndërkom-bëtare në afat të shkurtë duke harruar kontaktin me qytetarë

Ekziston një trysni tejet e madhe brenda partive për t'ju përgjigjur bashkësisë ndërkom-bëtare në vend se votuesve të tyre që vë në pah ndjeshmërinë e tyre ndaj të parës. Kjo ka sjellë deri tek një marrëdhënie flirti me bashkësinë ndërkom-bëtare ku partitë ndje-hen nën presion gjithnjë e më të madh t'u përgjigjen kërkesave të paqësimit të rajonit e gjithnjë e më pak t'u përgjigjen kërkesave vendore. Partitë duhet të zgjedhin ndërmjet këtyre dy trendeve skizofrenike dhe përderisa pakënaqësia publike është në rritje, mund të shohim ose dalje nga shtegu i standardeve apo frustrim gjithnjë e më të madh të votuesve të cilët do të ndëshkojnë udhëheqësit. Kjo mund të jetë gjë e mirë në afat të gjatë në rast se përmirësohet efektshmëria e partive si dhe imazhi i të njëjtave në opin-ionin e gjerë. Por, kjo mund të ndodhë vetëm nëse ka më pak lajme për korrupsion dhe nëse plotësohen kërkesat e grupeve të ndryshme. Siç pat thënë një analist i njohur i Ballkanit, bashkësia ndërkom-bëtare pret që politikanët vendorë, pas flirtit me votuesit gjatë zgjedhjeve të martohen me bashkësinë ndërkom-bëtare. Bashkësia ndërkom-bëtare duhet të ngul këmbë që në Kosovë të zë vend demokracia e mirëfilltë, dhe jo t'u japë kurajo udhëheqësve që kryesisht janë të gatshëm që në afat të shkurtë t'i përmbushin kërkesat e bashkësisë ndërkom-bëtare duke i harruar ata që i kanë zgjedhur në pozitë që mbajnë.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Zgjedhjet paraqesin formën themelore të pjesëmarrjes politike të qytetarëve. Në demokracitë e konsoliduara alternativat për pjesëmarrje qytetare shkojnë tutje mundësi periodike për të dhënë votën. Në demokracitë e reja dhe ato në lindje e sipër, si Kosova, alternativat në fjalë janë tejet të kufizuara. Mungesa e mundësive serioze që në mënyrë konstruktive të kanalizohen parapëlqimet e qytetarëve në procesin vendimarrës thërret për vëmendje më të lartë ndaj formave kryesore të veprimit politik. Pjesëmarrja e gjerë në zgjedhje është thelbësore për ndryshime pozitive drejt vendimarrjes me pjesëmarrje të gjerë në Kosovë.

Marrë në përgjithësi, ky punim nuk ka për qëllim shpjegimin e gjithëmbarshtëm të arsyeve për rënien e pjesëmarrjes në zgjedhje apo të bëjë interpretimin përfundimtar për të gjitha trendet e sjelljeve zgjedhore. Megjithatë, në punim tërhiqet vëmendja për vakuumin e rrezikshëm të legjitimitetit që është duke u krijuar. Përfaqësimi që nuk ofron përgjegjësi para votuesve dhe mungesa e lidhjeve personale ndërmjet qytetarit dhe përfaqësuesve po e ushqen mosinteresimin politik. Tutje, kjo po e pengon këmbimin e shëndoshë të informatave ndërmjet qytetarëve dhe partive, krahas krijimit të pengesave serioze për mobilizimin e votuesve. Qeverisja partiake, që shihet si joadekuate, po i kontribuon humbjes së legjitimitetit ndër qytetarë, gjë që shihet edhe nga vënia përballë e numrave të votuesve me numrat e atyre që nuk votojnë.

Siç shihet nga trendet zgjedhore, çështjet lokale po fitojnë rëndësi më të madhe. Në nivelin lokal, shquhen dy tipe mjaft të rëndësishme të sjelljeve zgjedhore. E para, një numër i konsiderueshëm dhe në rritje i votuesve po ndëshkon ata që janë në pushtet duke e kthyer përkrahjen ngadalë në drejtim të opozitës lokale. Ky është trend pozitiv që tregon se vendimet e marra mbështeten në atë çfarë presin votuesit nga përfaqësuesit e zgjedhur dhe nga rezultatet e këtyre të fundit. E dyta, edhe zgjedhjet në nivelin qendror po përcjellin trendin e zgjedhjeve lokale. Si pasojë e distancës ndërmjet qytetarëve dhe qeverisë qendrore, përfytyrimi për gjithë IPVQ-të po keqësohet. Rrjedhimisht, qytetarët gjithnjë e më shumë po zgjedhin nivelin qendror mbi themelet e perceptimeve të tyre lokale.

Pjesa më e madhe e votuesve po demonstroi dhe tregon pafuqinë e vet ndaj të gjitha partive duke mos votuar fare përderisa është e privuar nga mjetet e tjera të pjesëmarrjes politike legjitime. Për fat të keq, secili nga trendet e përmendura është i ngadalshëm për të ndikuar vendosmërisht veprimet e partive më të mëdha.

Kur mosbesimi sa vjen e shtohet, bashkë me ndjenjën e pafuqisë, korrupsionit dhe të paaftësisë në qeverisje, demokracia kosovare nuk ecën në drejtimin e duhur. Përkundër

çështjeve shumë të rëndësishme me të cilat Kosova përballet gjatë fazës së përcaktimit të statusit, një ndër to patjetër se duhet të jetë edhe demokracia. Në fund të fundit, kjo edhe paraqet një ndër standardet kryesore. Megjithatë, ndryshimet kozmetike pa e prekur thelbin e ndër-veprimit politik në Kosovë do t'u jepnin mesazhin më të keq atyre që për kohë të gjatë kanë presin një demokraci tjetër nga ajo që e shohin sot.

Rekomandimet:

1. Ndryshimi i sistemit zgjedhor. Duhet ndryshuar sistemin zgjedhor, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Përderisa gjatë viteve të kaluara është diskutuar gjatë për sistemin zgjedhor për Kuvendin e Kosovës, është thelbësore që të shtohen një varg rekomandimesh për procedurat e zgjedhjes së përfaqësuesve lokalë dhe të kryetarit të Kosovës.

2. Debatet publike. Përveç sistemit zgjedhor të rekomanduar nga “Reforma 2004”, është me rëndësi që të ketë diskutime publike se a duhet të ketë apo jo Kosova kryetar të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë.

3. Parimet udhëheqëse. Parime nga të cilat duhet të udhëhiqen aktet ligjvënëse nga këto lëmi:

- Llogaridhënie më e mirë
- Paanshmëri ndaj të gjitha partive politike
- Pjesëmarrje të efektshme të pakicave
- Integrim i efektshëm politik
- Përfaqësim i efektshëm i bazës zgjedhore
- Pjesëmarrje e efektshme e votuesve
- Qeverisje, parlament dhe parti politike të efektshme
- Mbi të gjitha, rivendosje të legjitimitetit

4. Diskutime për zgjedhjet lokale. Diskutime të ngjashme duhet të bëhen edhe për zgjedhjet lokale. Qytetarët duhet të debatojnë për përparësitë dhe të metat e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kryetarit të komunës dhe se a duhet të ketë lista të hapura për zgjedhjen e këshilltarëve komunalë. Diskutimet e niveleve të ndryshme duhet gjithashtu të përfshijnë shqyrtimin e mekanizmave për përfaqësim të duhur gjinor dhe të pakicave.

5. Rekomandojmë që ligji për zgjedhjet komunale të ardhshme të përfshijë:

- **Lista të hapura.** ku këshilltarët zgjedhen drejtpërsëdrejti nga qytetarët me të drejtë të përgjithshme dhe të barabartë të votës.

- **Përfaqësim përpjesëtimor.** Si pasojë e gjendjes pas-konfliktuale dhe praktikave të pakonsoliduara të garës politike çdo shpërpjesëtim mund të kuptohet si mashtrim dhe si i tillë bartë në vete gjasat e nxitjes së pakënaqësisë së thellë. Për këtë arsye llogaridhënia e drejtpërdrejtë përmes listave të hapura duhet të gërshetohet me sistemin e pastër përpjesëtimor në zgjedhjet lokale dhe qendrore për një kohë në të ardhmen.

